**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
**Qeveria-Vlada-Government**
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice**

---

# RAPORT VJETOR (Janar-Dhjetor 2025) PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR DREJTËSI TRANZICIONALE

Prill 2025

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet progresin në zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale për periudhën janar–dhjetor 2025.

Gjatë vitit 2025, nga gjithsej 88 aktivitete të planifikuara:

- 23 aktivitete janë zbatuar plotësisht (26%);
- 30 aktivitete janë zbatuar pjesërisht ose janë në zbatim e sipër (34%);
- 35 aktivitete nuk janë zbatuar (40%).

Këto të dhëna tregojnë se progresi në zbatimin e Strategjisë është në një nivel mesatar, me sfida të theksuara në realizimin e plotë të aktiviteteve të planifikuara.

Sfidat kryesore të identifikuara përfshijnë:

- kufizimet buxhetore;
- mungesën e koordinimit ndërinstitucional;
- kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe profesionale;
- ndryshimin e prioriteteve institucionale;
- mungesën e integrimit të aktiviteteve në planet legjislative dhe strategjike.

Raporti rekomandon masa konkrete për përmirësimin e zbatimit, përfshirë forcimin e koordinimit, rritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme financiare.

## II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale (2024-2034) dhe Plani i Veprimit të saj (2024-2026/7)[1] janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Qershorë të vitit 2024.

Sundimi i ligjit është një ndër parimet kryesore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës, në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 dhe Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, si dhe në Programin për sundimin e ligjit, në mënyrë specifike ka përcaktuar angazhimin e vet për hartimin e Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale. Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, Qeveria respektivisht MD, ka qene e angazhuar për identifikimin dhe promovimin e proceseve të ndryshme që do t'u

[1] Straegjia për Drejtësi Tranzicionale ka qenë në plan të miratohet në Dhjetor 2023 ose na Janar 2024, por që miratimi është bërë më 13 Qershorë 2024. Kjo do të thotë se Planii Veprimit i përcakaur për periudhën Janar 2024-Dhjetor 2026 ripëërcaktohet si periudhë Qershorë 2024-Qershorë 2027.

garantojnë viktimave të krimeve të luftës të drejtën për drejtësi dhe për të vërtetën përfshirë këtu edhe zhvillimin e një platforme reparative, e cila do të synojë përllogaritjen e dëmeve njerëzore dhe materiale të shkaktuara gjatë luftës.[2] Qasja gjithëpërfshirëse është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës, procesin e integrimit në BE dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, është vazhdimësi e angazhimit të institucioneve në drejtim të adresimit të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, adresimit të krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, krimit të gjenocidit dhe shkeljeve të vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, si dhe ofrimit të drejtësisë për viktimat dhe të mbijetuarit.

Që nga përfundimi i luftës në 1999, ballafaqimit më të kaluarën dhe drejtësisë tranzicionale në përgjithësi në Kosovë i ka munguar një vizion strategjik, përfshirja e mirëfilltë e kategorive të viktimave, si dhe qëndrueshmëria institucionale. Në mungesë të një vizioni dhe strategjie gjithëpërfshirëse, për më shumë se dy dekada autoritetet ndërkombëtare, ato vendore si dhe shoqëria civile angazhohen në iniciativa të fragmentuara e vetjake të drejtësisë tranzicionale. Mungesa e koordinimit institucional, si dhe mungesa e vazhdimësisë, qëndrueshmërisë të politikave qeveritare ka ndikuar që të mos ketë avancim për të kërkuar dhe njohur të vërtetën, drejtësi dhe reformim institucional. Për këtë arsye dhe me qëllim të krijimit të një platforme të qëndrueshme Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Drejtësisë ka hartuar këtë dokument strategjikë. Qëllimi i këtij dokumenti është krijimi i një një kornizë gjithëpërfshirëse për trajtimin e shkeljeve masive te të drejtave të njeriut dhe krimeve te luftës, përkatësisht për të ndërtuar themelet e një të ardhme paqësore. Qëllimi i Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale është që të ndihmojë të korrigjojë padrejtësitë dhe të shërojë traumat e shkaktuara nga e kaluara e dhimbshme. Përmes hartimit të strategjisë gjithëpërfshirëse nacionale për drejtësinë tranzicionale bëhet e mundshme krijimi i një platforme të qëndrueshme për të vendosur fakte për të kaluarën, duke siguruar kompensim për padrejtësitë dhe traumat e lidhura me luftën, mbrojtjen e kujtesës individuale dhe kolektive, reformimin dhe fitimin e besimit në institucione. Për më shumë, synimet e drejtpërdrejta të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale janë ̈që t'i japin fund mosndëshkimit dhe t'ua kthejnë dinjitetin viktimave. Duke vepruar në këtë mënyrë synimet afatgjata janë të fokusuara në parandalimin e konflikteve dhe shkeljeve te të drejtave njerëzorë, duke rivendosur besimin qytetar, pajtimin, sundimit e ligjit dhe rendit demokratik.

[2] Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025, faqe 14. I qasshëm në: https://kryeministri.rks-gov.net/wwp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf

Kjo Strategji është hartuar duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, [3] standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e drejtësisë tranzicionale. Rrjedhimisht strategjia bazohet në katër shtyllat e drejtësisë tranzicionale, përkatësisht **gjetjen e së vërtetës, drejtësinë, reparacionet dhe reformën institucionale**, të cilat janë edhe obligime shtetërore në Republikën e Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ajo siguron një rol qendror në marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjithashtu garanton mbrojtje të zgjeruar për të drejtat e komuniteteve pakicë. Këto vlera kushtetuese krijojnë bazën ligjore për transformim shoqëror dhe politik, në një shtet ligjor, gjithëpërfshirës e shoqëri të integruar, duke garantuar ndër të tjera që proceset shoqërore dhe politike të funksionojnë dhe të tejkalojnë trashëgiminë e diskriminimit, mos respektimit të dinjitetit njerëzor nga sistemet dhe regjimet e mëparshme represive.

Baza juridike ndërkombëtare apo e drejta ndërkombëtare mbi të cilën është mbështet hartimi i strategjisë është:

- Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- E drejta ndërkombëtare humanitare;
- E drejta penale ndërkombëtare dhe
- E drejta ndërkombëtare për refugjatët
- *"Parimet e përditësuara për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nëpërmjet veprimit për të luftuar mos ndëshkueshmerinë"*
- *"Parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën në dëmshpërblime dhe kompensim për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve serioze të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare";*
- "*Kornizën e Politikave të Bashkimit Evropian për mbështetjen e drejtësisë tranzicionale"*

## Vizioni i strategjisë

[3] Kushtetuta e Republikës së Kosovës është miratuar më 9 prill 2008, ndërsa ka hyrë në fuqi me 15 qershor 2008. Kushtetuta që nga hyrja në fuqi e deri me tani (nëntor 2022) ka pasur 26 amendamente: Amendamentet 1-22 të Kushtetutës, lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 25, 7 shtator 2012), Amendamentin 23 (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 26 mars 2013), Amendamentin 24 (Gazeta Zyrtare, Nr. 20, 05 gusht 2015), Amendamentin 25 (Gazeta Zyrtare, Nr. 9, 11 mars 2016) dhe Amendamentin 26 (Gazeta Zyrtare, nr. 4, 30 shtator 2020).

Vizioni i Kosovës për drejtësinë tranzicionale është krijimi i një platforme strategjike që synon realizimin e të drejtës së viktimave dhe shoqërisë për të vërtetën, reparacionin, drejtësinë dhe garancitë për mospërsëritje.

### Qëllimet e strategjisë

Qëllimet e Strategjisë janë: adresimi i krimeve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, ligjit ndërkombëtar humanitar dhe krimeve tjera që janë e shkelje e së drejtës ndërkombëtare

### Periudha

Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale trajton periudhën kohore 1989-2000, përkatësisht nga 1989, vitin e suprimimit të autonomisë juridike e politike të Kosovës dhe fillimin e shkatërrimit të rendit kushtetues të ish-RSFJ, periudhën e luftës 1998 -1999 deri ne vitin 2000, bazuar në parimet dhe vlerat e mëposhtme:

- Qasjen e përqendruar te viktima;
- Qasjen gjithëpërfshirëse;
- Ndjeshmërinë gjinore;
- Pajtueshmërinë me normat dhe standardet ndërkombëtare;
- Integritetin dhe paanshmërinë;
- Pjesëmarrjen dhe fuqizimin;
- Barazinë dhe mosdiskriminimin;
- Parimin “mos lëndo”.

Duke u bazuar në vlerat e cekura, strategjia synon:

- Të mundësojë vendosjen e dialogut social për të kaluarën, përmes drejtësisë restauruese;
- T’i sigurojë kushtet e nevojshme për arritjen e drejtësisë për të gjitha viktimat;
- Të sigurojë zbatimin e një procesi gjithëpërfshirës, transparent të mbështetjes materiale, simbolike dhe psiko-sociale për të gjitha viktimat;
- Të sigurojë që të gjitha objektivat strategjike e respektojnë ndjeshmërinë gjinore dhe se çdo program përfshin masa për t’i eksploruar përvojat gjinore dhe për t’i korrigjuar shkeljet në baza gjinore.

### Plani i Veprimit të Strategjisë

Në realizim dhe zbatim të kësaj strategjie është hartuar edhe plani i veprimit i cili ka katër objektiva strategjike (të bazuara në katër parimet e cekura), 17 objektiva specifike dhe 114 aktivitet. Përkundër që strategjia është 10 vjeçare, plani i veprimet është 3 vjeçar dhe i cili do të rishikohet çdo tre vjet. Plani Veprimit përfshin periudhën Qershor 2024-Qershor 2027. Sipas planit të veprimit, aktivitetet jane të shtrira në tre vite, nga të cila një pjesë janë vetëm për një vit e një pjesë duhet nisur në vitin e parë dhe vazhdojnë pa ndërprerë edhe në vitet tjera. Sipas ndarjes ne vite, aktivitetet jane planifikuar të nisin ose të zhvillohen si më poshtë:

- **2024-71 Aktivitete**
- **2025- 88 aktivitete**
- **2026-69 aktivtete**

**Procesi i mbledhjes së të dhënave**

Bazuar në nenin 22, paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, si ministër bartës, ka përgjegjësi për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të dokumentit strategjik të miratuar. Në përputhje me këtë, me Vendimin nr. 349/2024, datë 27.09.2024, është emëruar Grupi Ndërministror për Monitorimin dhe Zbatimin e Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale.

Mbledhja e të dhënave për hartimin e këtij raporti është realizuar përmes një plani joformal të përgatitur nga Divizioni për Drejtësi Tranzicionale, i cili është miratuar nga Grupi Ndërministror. Gjatë vitit 2024, Grupi Ndërministror është takuar dy herë, ndërsa gjatë vitit 2025 nuk ka pasur takime. Në këto mbledhje është dakordësuar procesi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit.

Përmes këtij procesi janë caktuar zyrtarë përgjegjës kontaktues në secilën ministri dhe institucion publik, të cilët kanë detyrë të komunikojnë me Divizionin për Drejtësi Tranzicionale në MD, të mbledhin të dhënat përkatëse dhe të raportojnë për zbatimin e Planit të Veprimit sipas përgjegjësive të institucioneve respektive.

Për të lehtësuar procesin e raportimit, Divizioni për Drejtësi Tranzicionale ka përgatitur një plan pune që përfshinë:

- Ndarjen e aktiviteteve nga Plani i Veprimit të Strategjisë sipas përgjegjësive të secilit institucion dhe dërgimin e tyre për zbatim;
- Hartimin e dhjetë dokumenteve udhëzuese për institucionet e të tre pushteteve;
- Zhvillimin dhe shpërndarjen e një formati elektronik në programin Excel për raportim;

- Organizimin e tryezave/punëtorive me zyrtarët kontaktues për prezantimin e formatit të raportimit, mënyrës së plotësimit dhe dakordësimin e afateve të raportimit;
- Krijimin e një fushe informimi me institucionet, përmes së cilës janë zhvilluar takime ballë për ballë me udhëheqësit e institucioneve, si dhe punëtori/tryeza tematike;
- Hartimin e dokumenteve të posaçme për aspekte të veçanta të zbatimit të Strategjisë, sidomos në fushën e ndërtimit të kapaciteteve.

Në zbatim të nenit 22, paragrafi 3 i Rregullores (QRK) Nr. 17/2024, është hartuar Raporti Vjetor për periudhën janar–dhjetor 2025, në të cilin paraqiten arritjet kundrejt objektivave, afatet kohore të aktiviteteve dhe veprimet e ndërmarra.

**Arritjet kundrejt objektivave përmes treguesve të vendosur dhe afati kohor i veprimeve të ndërmarra**

Aktivitetet për këtë periudhë të Strategjisë janë vlerësuar në bazë të katër kategorive vlerësuese: 1) të planifikuara 2) të zbatuara plotësisht; 3) të zbatuara pjesërisht ose në zbatim e sipër; dhe 4) të pazbatuara.

| | |
|---|---|
| Te planifikuara | 88 |
| Te zbatuara plotësisht | 23 |
| Të Zbatuara pjesërisht | 30 |
| Të pazbatuara | 35 |

Figura.1




Figura 2




Figura 3

Tabela në vijim paraqet zbatimin e aktiviteteve me përqindje sipas institucioneve që i kanë udhëhequr ato. Tabela në vijim paraqet zbatimin e aktiviteteve me përqindje për vitin 2025,

sipas institucioneve që i kanë udhëhequr ato. Duhet cekur për sqarim se ka aktivitete që janë në përgejgësi të më shumë se një institucioni. Githashtu ka aktivitete që kan fillaur në 2024 dhe vazhdojnë në vitete pasuese. Kjo është arsyeja se nurmi i aktiviteteve në këtë tabelën nuk është njejtë me tabelën siper, figura. 1.

| Institucioni | Numri i aktiviteteve | Përqindja e zbatimit të plotë | Përqindja e aktiviteteve në zbatim e sipër | Përqindja e aktiviteteve të pazbatuara |
|---|---|---|---|---|
| Ministria e Drejtësisë – Instituti për Mjekësinë Ligjore | **22** | 18,18% | 31,81% | 50% |
| Presidenca | **3** | 66,66% | 0% | 33,33% |
| Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovvës | **12** | 8.33% | 16% | 75% |
| Zyra e Kryeministrit | **16** | 31,25% | 43.75% | 25% |
| Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - Agjencia e Arkivave – Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale | **20** | 10% | 60% | 30% |
| Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës – Instituti për Administratë Publike | **9** | 33,33% | 22,22% | 44,44% |
| Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Agjencia e Punësimit | 11 | 36,36% | 27,27% | 36,36% |
| Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit - Universiteti i Prishtinës dhe Instituti i Historisë | 11 | 0% | 27,27% | 72,72% |
| Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike | **3** | 33,33% | 0% | 66,66% |
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës | 1 | 0% | 0% | 100% |
| Instituti për Krimet e Kryera Gjatë Luftës | **10** | 40% | 40% | 20% |
| Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur | **5** | 60% | 20% | 20% |
| Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës | **5** | 80% | 0% | 20% |
| **Total numri i aktiviteteve** | **128** | | | |

Figura 4

## Burimet financiare

Në zbatim të Planit të Veprimit, përkatësisht në realizimin e aktiviteteve, janë shfrytëzuar kryesisht burime nga buxheti i Republikës së Kosovës. Megjithëse është kërkuar nga institucionet raportuese që të evidentojnë dhe raportojnë rastet kur aktivitetet janë financuar nga donatorë të mundshëm, nuk është pranuar asnjë informacion lidhur me financim të tillë.

## Pengesat kryesore të zbatimit

Megjithëse ky është viti i parë i zbatimit të Strategjisë, është konstatuar se ekzistojnë një sërë mangësish që kanë ndikuar në realizimin e aktiviteteve të planifikuara. Këto mangësi lidhen kryesisht me kufizime buxhetore, planifikim të pamjaftueshëm, koordinim të dobët ndërinstitucional, mungesë të kapaciteteve njerëzore, si dhe mungesë të njohurive specifike dhe të konsistencës në zbatim.

Vlen të theksohet se moszbatimi i aktiviteteve, si dhe vonesat apo ngecjet në realizimin e tyre, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave të Strategjisë, të cilat maten përmes indikatorëve të përcaktuar. Në këtë drejtim, performanca e përgjithshme në zbatim reflekton edhe nivelin e arritjes së rezultateve strategjike.

## Çfarëdo faktori të ri që ndikon në zbatim

Gjatë periudhës së monitorimit, përveç faktorëve të përmendur më parë, janë identifikuar edhe faktorë të rinj që kanë ndikuar në zbatimin e plotë dhe të planifikuar të Planit të Veprimit. Një faktor kryesor është zhvendosja e prioriteteve dhe mungesa e vazhdimësisë së fokusit në aktivitetet e planifikuara.

Gjithashtu, është vërejtur se disa institucione operojnë me mandate të mbivendosura, çka ka shkaktuar zhvendosje ose shpërndarje të përgjegjësive individuale. Faktor tjetër është mospërfshirja e aktiviteteve të planifikuara në planet legjislative dhe në aktet normative të parashikuara për ndryshim ose plotësim.

Sfidat përfshijnë gjithashtu reduktimin ose uljen e fondeve si pasojë e prioriteteve të reja globale, mosdakordësinë e disa donatorëve me përmbajtjen e Strategjisë dhe ndryshimin e destinimit të fondeve sipas prioriteteve të reja brenda vendit. Këto faktorë kanë ndikuar drejtpërdrejt në vonesat dhe në zbatimin jo të plotë të aktiviteteve strategjike.

## Masat e sugjeruara korrigjuese, duke përfshirë sigurimin e fondeve që mungojnë

Një nga masat kryesore të sugjeruara është sigurimi i fondeve të qëndrueshme brenda buxhetit të shtetit, duke rishikuar dhe optimizuar planifikimin vjetor. Njëherësh, është e domosdoshme të eksplorohen mundësitë e koordinimit me partnerët dhe donatorët e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht në kuadër të proceseve integruese.

Një tjetër masë e domosdoshme është ngritja e kapaciteteve, përfshirë sidomos ndërmjet IKAP-it, si dhe organizimi i trajnimeve specifike për hulumtim dhe krijim të politikave, sidomos në fusha të caktuara si shëndeti publik.

Në këtë kuadër, masat konkrete që duhet të ndërmerren përfshijnë:

- Sigurimin e një linje specifike dhe rishikimin e politikave të buxhetit;
- Funksionalizimin e Grupit Ndërministror për Monitorim;
- Ndërtimin e kapaciteteve specifike në institucionet përgjegjëse;
- Identifikimin dhe prioritarizimin e aktiviteteve kyçe për zbatim;
- Krijimin e një fondi të përbashkët në dakordësi me donatorët.

Këto masa synojnë të garantojnë zbatim më efektiv të Strategjisë dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave të saj afatgjata.

# III. ANALIZË E PROGRESIT TË ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE

Analiza e të dhënave për vitin 2025 tregon një nivel të moderuar të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale, me dallime të dukshme ndërmjet institucioneve dhe llojeve të aktiviteteve.

Nga gjithsej 88 aktivitete të planifikuara për këtë periudhë, vetëm 26% janë zbatuar plotësisht, ndërsa 34% janë në zbatim e sipër. Përqindja e lartë e aktiviteteve të pazbatuara (40%) tregon për sfida strukturore në implementimin e Strategjisë, veçanërisht në aspektin e koordinimit, planifikimit dhe burimeve.

## Interpretimi i nivelit të zbatimit

Shkalla e zbatimit të plotë (26%) sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve nuk ka arritur të përfundojë brenda afateve të planifikuara. Megjithatë, fakti që 34% e

aktiviteteve janë në proces zbatimi tregon se ekziston një nivel i caktuar i angazhimit institucional, por me vonesa në realizim.

Ky kombinim i indikatorëve sugjeron një **hendek ndërmjet planifikimit dhe zbatimit real**, ku aktivitetet iniciohen, por nuk përfundohen në kohë.

**Analiza sipas institucioneve**

Të dhënat tregojnë dallime të theksuara në performancën institucionale:

- Institucionet me mandat të qartë dhe funksione specifike (si komisionet qeveritare) kanë arritur përqindje më të larta të zbatimit të plotë (deri në 60–80%).
- Institucionet me përgjegjësi më të gjera dhe ndërsektoriale (si ministritë) kanë treguar nivele më të ulëta të zbatimit dhe përqindje më të lartë të aktiviteteve të pazbatuara.
- Disa institucione (p.sh. në fushën e arsimit dhe diplomacisë) kanë nivele shumë të ulëta të zbatimit (0–27%), duke reflektuar mungesë prioritizimi ose kapacitetesh.

Kjo tregon se **qartësia e mandatit dhe specializimi institucional janë faktorë kyç për sukses në zbatim**.

**Ndikimi i natyrës së aktiviteteve**

Analiza tregon se:

- Aktivitetet që kërkojnë **koordinim ndërinstitucional** kanë pasur më shumë vonesa dhe nivele më të ulëta të zbatimit.
- Aktivitetet që varen nga **burimet financiare shtesë** janë më shpesh të pazbatuara.
- Aktivitetet që janë **teknike dhe brenda mandatit të një institucioni të vetëm** kanë pasur performancë më të mirë.

Kjo sugjeron se kompleksiteti i aktivitetit ndikon drejtpërdrejt në probabilitetin e realizimit të tij.

**Identifikimi i trendeve kryesore**

Nga analiza e përgjithshme dalin disa trende:

- Ekziston një tendencë e **fillimit të aktiviteteve pa përfundim brenda afateve**;
- Ka një **varësi të lartë nga faktorët e jashtëm**, si financimi dhe donatorët;
- Vërehet **mungesë e mekanizmave efektivë të ndjekjes dhe llogaridhënies**.

**Implikimet për zbatimin e Strategjisë**

Nëse trendi aktual vazhdon, ekziston rreziku që:

- objektivat strategjike të mos arrihen brenda afateve të parapara;
- të krijohet një hendek ndërmjet planifikimit strategjik dhe rezultateve reale;
- të ulet besueshmëria institucionale në zbatimin e politikave publike.

Për këtë arsye, është thelbësore që në fazat e ardhshme të zbatimit të ndërmerren masa konkrete për:

- forcimin e koordinimit ndërinstitucional;
- rritjen e kapaciteteve profesionale;
- përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit;
- sigurimin e burimeve të qëndrueshme financiare.

## IV. KONKLUZIONE

Analiza e zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2025 tregon se, megjithëse është arritur një progres i caktuar në operacionalizimin e Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale, niveli i përgjithshëm i realizimit mbetet nën pritjet e planifikimit fillestar dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme strukturore.

Shkalla e ulët e aktiviteteve të zbatuara plotësisht (26%) dhe përqindja e lartë e aktiviteteve të pazbatuara (40%) dëshmojnë për ekzistencën e një hendeku të theksuar ndërmjet planifikimit strategjik dhe kapaciteteve reale të zbatimit. Ky hendek reflekton jo vetëm sfida operative, por edhe kufizime sistemike në koordinimin ndërinstitucional, menaxhimin e burimeve dhe prioritizimin e politikave.

Gjetjet tregojnë se performanca institucionale është e pabarabartë, ku institucionet me mandat më të ngushtë dhe përgjegjësi të qarta kanë arritur rezultate dukshëm më të mira krahasuar me institucionet me mandate të gjera dhe ndërsektoriale. Kjo nënvizon nevojën për qartësim të përgjegjësive dhe forcim të mekanizmave të llogaridhënies.

Një ndër sfidat kryesore mbetet mungesa e një mekanizmi funksional dhe të rregullt të koordinimit ndërinstitucional, e reflektuar edhe në mosfunksionalizimin e plotë të Grupit Ndërministror gjatë vitit raportues. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në vonesat në zbatim, veçanërisht për aktivitetet që kërkojnë bashkëpunim ndërmjet institucioneve.

Po ashtu, mungesa e një planifikimi të qëndrueshëm financiar dhe integrimit të aktiviteteve të Strategjisë në kornizat buxhetore dhe legjislative ka kufizuar ndjeshëm kapacitetin për

zbatim efektiv. Varësia nga burime të pasigurta financimi dhe mungesa e raportimit të strukturuar për mbështetjen nga donatorët përbëjnë rrezik për qëndrueshmërinë e procesit.

Në aspektin operacional, evidentohet një prirje për fillimin e aktiviteteve pa përfundim brenda afateve të parapara, çka tregon për dobësi në planifikim, menaxhim të projekteve dhe ndjekje të progresit. Kjo situatë, nëse vazhdon, rrezikon të ndikojë negativisht në arritjen e objektivave strategjike dhe në kredibilitetin institucional.

Në këtë kontekst, për avancimin e zbatimit të Strategjisë në fazat e ardhshme, është e domosdoshme:

- forcimi i menjëhershëm i mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit, përfshirë funksionalizimin e plotë të Grupit Ndërministror;
- integrimi i plotë i aktiviteteve në planifikimin buxhetor dhe legjislativ;
- rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike të institucioneve zbatuese;
- vendosja e mekanizmave të qartë të llogaridhënies dhe raportimit;
- prioritizimi i aktiviteteve me ndikim të lartë dhe realizueshmëri më të madhe.

Në përfundim, viti i parë i zbatimit ka shërbyer si një fazë fillestare e rëndësishme për testimin e mekanizmave institucionalë dhe identifikimin e sfidave kryesore. Megjithatë, për të siguruar suksesin afatgjatë të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale, kërkohet një qasje më e strukturuar, më e koordinuar dhe më e mbështetur financiarisht në vitet në vijim

## V. INFORMATA TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE

Në vijim është prezantuar Plani i Veprimit të Strategjisë me kolonën në fund ku tregohet progresi në zbatim, siç rekomandohet nga Rregullorja (QRK-NR.17/2024 e Punës se Qeverise se Republikës së Kosovës, cila thotë "Ministria bartëse përgatitë raport vjetor mbi progresin e zbatimit te dokumentit strategjikë…".

Udhëzim:

Ngjyra e gjelbërt tregon zbatimin e plotë të një aktiviteti

Ngjyra e portokalltë tregon zbatimin e pjesshëm apo se një aktivitet është në zbatim e sipër

Ngjyra e kuqe tregon se aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të

Ngjyra e bardhë tregon se aktiviteti është i planifikuar për vitet pasuese

## VI. PLANI I VEPRIMIT

**9. PLANI I VEPRIMIT**

Planii veprimit përbëhet nga 3 seksione:

a) Seksioni 1: Objektivi strategjik dhe indikatorët e tij
b) Seksioni 2: Objektivi specifik dhe indikatorët e tij
c) Seksioni 3: Veprimet e ndërlidhura me objektivat specifike

| Nr. | Objektivat strategjike dhe specifike, dhe veprimet | Pikënisja [2024] | Synimi afatmesëm [2025] | Synimi përfundimtar [2026] | Rezultati | Progresi në zbatim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Objektivi strategjik: Dokumentimi dhe publikimi i fakteve dhe rrethanave të krimeve të kryera gjatë luftës | | | | | |
| 1.1 | Objektivi specifik: Krijimi i mekanizmit institucional për dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës | | | | | |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Rezultati | Referencat në dokumente | Progresi në zbatim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.1 | Hartimi i akteve nënligjore sipas Ligjit për Institutin për Dokumentimin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë | T M2 2024 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Kryeministrit | Aktet nënligjore të miratuara | Ligji për Institutin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë | Sipas të dhënave të mbledhura aktet nënligjore janë kompletuar dhe ka filluar zbatimi i tyre. |
| 1.1.2 | Funksionalizimi i Institutit për Dokumentimin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë | T M3 2024 | 1,113,165.00 | 1,565,560.00 | 1,634,192.00 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Zyra e Kryeministrit | Instituti funksional me infrastrukturë të nevojshme fizike, burime njerëzore dhe linjë buxhetore | Ligji për Institutin për Dokumentimin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë | Funksional |
| 1.1.3 | Forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të stafit në fushat relevante për mandatin e Institutit | T M4 2024 | 0 | 0 | 0 | | Instituti për krimet e luftës të kryera gjatë luftës | Zyrtarët e Institutit të trajnuar | Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë | Zyrtarët e Institutit të trajnuar<br><br>Zhvillimi profesional i stafit mbetet një prioritet thelbësor i Institutit. Gjatë këtij viti programet trajnuese janë përqendruar në avancimin e aftësive digjitale, përdorimin e sistemeve të arkivimit elektronik |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | dhe përvetësimin e metodologjive bashkëkohore të hulumtimit certifikimit dhe dokumentimit. Të gjithë zyrtarët e rinj kanë ndjekur trajnimin bazë për nëpunësit civilë, të organizuar nga Institutin i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ndërsa dhjetëra zyrtarë kanë marrë pjesë në trajnime të specializuara për mbrojtjen e të dhënave personale, menaxhimin e kontratave dhe planifikimin buxhetor. Për më tepër, në bashkëpunim me IKAP-in, është organizuar kursi tremujor i gjuhës serbe, i ndjekur nga 16 zyrtarë, për të mundësuar qasje më të drejtpërdrejtë në dokumentet burimore në këtë gjuhë. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Po ashtu gjatë vitit 2026, Instituti i Kosovës për Krime të Luftës (IKKL) ka planifikuar rritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të tij përmes trajnimeve specifike ndërkombëtare në Australi, Izrael, Angli dhe Kanada, si dhe përmes trajnimeve të specializuara brenda vendit. Këto aktivitete të ngritjes së kapaciteteve kanë për qëllim forcimin e kompetencave profesionale dhe avancimin e nivelit të profesionalizmit të stafit të IKKL-së në fushat që mbulon Instituti, në veçanti në hulumtimin, analizimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.4 | Analiza krahasuese për krijimin e institucionit muzeor për dokumentimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë në Kosovë | T M1 2024 | 0 | 0 | 0 | | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Raporti i analizës krahasuese | N/A | Koncepti per themelimin e Muzeut per dokumentimin dhe prezantimin e krimeve te ish Jugosllavise dhe Serbise ndaj shqipetareve ne Kosove eshte hartuar nga grupi punues i themeluar me vendim te Qeverise se Republikes se Kosoves dhe eshte dorezuar ne Qeveri. |
| 1.1.5 | Hartimi i bazës ligjore për krijimin e institucionit muzeor për dokumentimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë në Kosovë. | T M2 2024 | 1,500.00 | 0 | 0 | Buxheti i Kosovës/Donatorët | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Baza ligjore e vendosur | N/A | Ne dhjetor te 2024 eshte miratuar vendimi per themelimin e Muzeut te Gjenocidit dhe Perpjekjes per Liri, propozim i perpiluar nga grupi punues i themeluar me vendim te Qeverise se Republikes se Kosoves. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.6 | Hulumtimi, kurimi dhe funksionalizimi i institucionit muzeor për dokumentimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë në Kosovë | T M1 2025 | 50 000 | 50 000 | 50 000 | Buxheti i Kosovës/D onator ët | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Funksioni mi i plotë i institucionit muzeor për dokumentimi n e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë në Kosovë | N/A | Pas miratimit te vendimit per themelimin e Muzeut te Gjenocidit dhe te Perpjekjes per Liri, MKRS eshte duke pergatitur detyren projektuese per konceptin muzeor dhe arkitektonik te nderteses. Gjate muajit maj do te shpallen procedurat per hartimin e projektit muzeor dhe arkitektonik te muzeut. |
| **1.2** | **Objektivi specifik: Intensifikimi i procesit të zbardhjes së fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur** | | | | | | | | | |
| 1.2.1 | Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur | 20 24 | 1,500. 00 | 0 | 0 | Buxheti i Kosovës/D onator ët | Zyra e Kryeministrit/ Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur | Ligji për personat e pagjetur i ndryshuar dhe plotësuar i miratuar | N/A | Një draft fillestar i projektligjit ka qenë i përgatitur, por procedimi i tij është shtyrë në pritje të adresimit të kërkesave të familjeve, të cilat aktualisht janë të rregulluara me dy ligje të veçanta në fuqi. Megjithatë, projekligji është paraparë në |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Agjendën Legjislative të këtij viti, me mundësinë e procedimit të mëtejmë në koordinim dhe me përkrahjen e Ministrit për Punën, Familjen dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, së bashku me aktet e tjera që bien në mandatin e kësaj ministrie. |
| 1.2.2 | Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me | 2024 | 1,500.00 | **0** | 0 | Buxheti i Kosovës/Donator ët | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Njohja e statusit të personave të zhdukur me forcë nga Kosova në përputhje me Ligjin për Personat e Zhdukur | N/A | I pazbatuar |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ligjin nr. . 04/L-172 | | | | | | | | | |
| 1.2.3 | Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore | 20 24 | 0 | 0 | 0 | | Ministria e Drejtësisë | Ligji me ndryshime dhe plotësime i miratuar | N/A | I pazbatuar |
| 1.2.4 | Hartimi i aktit nënligjor për ndërprerjen e kërkimit të personave të zhdukur me forcë | T M3 2024 | 1,500. 00 | 0 | 0 | Buxheti i Kosovës/D onator ët | Ministria e Drejtësisë | Rregullorja e miratuar | N/A | Grupi Punues per hartimin e ketij akti nenligjor eshte takuar gjate nje punetorie dy ditore gjate dhjetorit te 2025 dhe ka punuar nje nje draft pune, I cili ende eshte duke u perpunuar nga Departamenti Ligjor I MD-se. Ky draft duhet te dergohet serish te anetaret e GP per komente para se procedohet me tutje |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.5 | Rritja e kapaciteteve të Institutit të Mjekësisë Ligjore në fusha specifike | 20 24 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Ministria e Drejtësisë | Kapacitetet e zyrtarëve të IML-së të forcuara Krijimi i Divizionit për identifikimin e personave të zhdukur | Ligji Nr. 05/L-060 për Mjekësin ë Ligjore/S trategj ia për Zhvillimi n e Institutit të Mjeksisë Ligjore 2022-2025 | Divizioni I Personave te Zhdukur ne IML eshte funksional ne baze te Rregullores per organizim te brendshem dhe sistematizim te vendeve te punes ne IML (01-2025), mirepo ende nuk ka filluar zbatimi I saj ne praktike per shkak te mungeses se Rregullores per Klasifikimin e vendeve te punes (e cila eshte ne proces). Sidoqofte, divizioni funksionon me kapacitetet ekzistuese te cilat pritet te rriten dhe forcohen pas zbatimit te plote te Rregullores me rekrutimin e dy profileve profesionale (arekologut forenzik dhe analistit forenzik). |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.6 | Ri-inventarizimi/ri-ekzaminimi i detajuar i të gjitha rasteve të mbetjeve mortore në morgun e IML-së | 2024 | 15,000 | 15,000 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Ministria e Drejtësisë/Instituti i Mjekësisë Ligjore/ Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur | Mbetjet mortore të ri-inventarizuara/identifikuara | Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur / Strategjia për Zhvillimin e Institutit të Mjeksisë Ligjore 2022-2025 | Procesi i rishikimit te mbetjeve mortore ne IML ka vazhduar me nje hap me te ngadalshem per shkak te kushteve joadekuate te punes si pasoje e procesit te renovimit. Megjithate, ky proces ka shenuar progres dhe pritet te intensifikohet me rifillimin e punes ne hapesirat e renovuara te IML, duke perfshire sallen e antropologjise mjeko ligjore |
| 1.2.7 | Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur | 2024 | 13,728 | 13,728 | 13,728 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Zyra e Kryeministrit | Stafi i ri i rekrutuar / Kapacitetet e KPZH-së të forcuara | Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë/ Strategjia për Zhvillimin e Institutit të Mjeksisë Ligjore | Siç kemi raportuar edhe gjatë vitit paraprak, në kuadër të përforcimit të kapaciteteve, janë rekrutuar dy zyrtarë të rinj në strukturën e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur (respektivisht në |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | 2022-2025 | Njësinë e KQPZH-së). |
| 1.2.8 | Krijimi i mundësive buxhetore për mbështetjen e vazhdueshme të familjeve dhe aktiviteteve të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur me forcë | 2024-2025-2026 | 50.000 | 50.000 | 50.000 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Qeveria e Republikës së Kosovës / Zyra e Kryeministrit / MFPT Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur / IML | Mbështetja e ofruar / Format e identifikuara për mbështetjen në të ardhmen për familjet dhe shoqatat e familjeve | | Përkundër kërkesës zyrtare të Kryesuesit të Komisionit që gjatë vitit 2025 të procedohet me përkrahje financiare të shoqatave të familjeve përmes një thirrjeje publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kjo kërkesë nuk është proceduar tutje. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2025 nuk ka qenë e mundur të realizohet mbështetje direkte buxhetore për shoqatat përmes mekanizmave institucionalë të brendshëm. Përkrahja e |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | aktiviteteve të tyre është siguruar kryesisht përmes bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. |
| 1.2.9 | Përgatitja e raporteve vjetore për punën e KQPZH- së dhe IML-së | 2024 - 2025 - 2026 | 0 | 0 | 0 | | KQPZH/IML | Raportet e përgatitura | Ligji Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore - Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur | Raporti i përgatitur nga KQPZH dhe IML |
| 1.2.10 | Unifikimi i të dhënave të personave të zhdukur | 2025 | 0 | 0 | 0 | | KQPZH | Baza e të dhënave e përditësuar | Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur / Strategjia për Zhvillimin e | Është funksionalizuar me të dhënat minimale Moduli për Personat e Zhdukur në kuadër të Bazës së të Dhënave iDMS. Puna do të vazhdojë me funksionalizimin e |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Institutit të Mjeksisë Ligjore 2022-2025 | moduleve tjera (Moduli i Familjes dhe Moduli i Operacioneve Fushore), si dhe me 'popullimin' e vazhdueshem të të dhënave, bazuar në dosjet e skanuara dhe dokumentacionin ekzistues. |
| 1.2.11 | Masat avokuese, organizimi i iniciativave lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në adresimin e çështjes së personave të zhdukur me forcë. | 2024 - 2025 - 2026 | 0 | 20.000 | 20.000 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | KQPZH | Iniciativat e organizuara | Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur | Janë organizuar aktivitete përkujtimi e ndërgjegjësimi, në veçanti me rastin e shënimit të datave të veçanta. Ku në këtë vit , do të theksonim edhe përkrahjen dhe pjesëmarrjen në ‘Marshin në Gjenevë’ në shënimin e 30 Gushtit – Ditës Ndërkombëtare për Viktimat e Zhdukjes me Forcë. |
| 1.2.12 | Forcimi i kapaciteteve të sektorit për personat e zhdukur në Drejtorinë e | 2024 - 2025 - 2026 | 39,072.00 | 39,072.00 | 39,072.00 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | MPB/PK | Stafi i rekrutuar | N/A | Gjatë vitit 2024 në Sektorin për persona të zhdukur jane rekrutuar 2 hetues me vendime për |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Krimeve të Luftës në PK | | | | | | | | | sistemim për kohë të pacaktuar, ndërsa në vitin 2025 jane rekrutuar 1 rreshter dhe 1 hetues me vendim për sistemim për kohë të pacaktuar. Ndërsa gjate vitit 2026 planifikohet të rekrutohet staf shtesë . 2 zyrtare mungojne ne kete Sektor |
| **1.3** | **Objektivi specifik: Marrja e dokumentacionit relevant nga organizatat ndërkombëtare** | | | | | | | | | |
| 1.3.1 | Ekzaminimi i gjendjes aktuale për dokumentet në dispozicion | 20 24 | 15,000 | 0 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Ministria e Drejtësisë | Përgatitja e raportit të statusit aktual | N/A | Është Përfunduar një hulumtim mbi mekanizmat publik dhe jo publik, qeveritar, jo qeveritar dhe ndër qeveritar që mund të kenë dokumentacion në lidhje me periudhën që e trajton Strategjia. |
| 1.3.2 | Dërgimi i kërkesave te mekanizmat ndërkombëtarë për mbledhjen e dokumentacionit | 20 24 - 2025 | 0 | 0 | 0 | | Instituti për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë | Kerkesat e derguara | Ligji për Institutin për Dokume ntimin e Krimeve të kryera | Gjatë vitit 2025, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka forcuar ndjeshëm rrjetin e bashkëpunimeve kombëtare, rajonale |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | gjatë Luftës në Kosovë | dhe ndërkombëtare, përmes nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh dhe memorandumesh mirëkuptimi me institucione shtetërore, akademike dhe kulturore. Këto marrëveshje kanë pasur për qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të institucionit, zgjerimin e burimeve dokumentare, si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën e dokumentimit, arkivimit dhe ruajtjes së kujtesës historike.<br>Gjatë periudhës raportuese të vitit 2025 janë formalizuar disa marrëveshje të reja bashkëpunimi, me institucione nga |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Republika e Shqipërisë, Mali i Zi dhe brenda Kosovës. Ndër partneritetet kyçe të realizuara gjatë kësaj periudhe përfshihen bashkëpunimet me: Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë; Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë; Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicat në Mal të Zi; Radio Televizionin e Malit të Zi (RTCG); Qendrën për Kulturë dhe Bibliotekën e Ulqinit; Komunën e Ulqinit; TV Teuta, si dhe institucione të tjera relevante. Po ashtu, IKKL ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Ambasadën e |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë dhe me institucione shtetërore të Shtetit të Izraelit, me fokus të veçantë në trajnime profesionale dhe shkëmbim përvojash në fusha specifike të hulumtimit, verifikimit, analizimit ,dokumentimit, arkivimit dhe menaxhimit institucional. |
| 1.3.3 | Administrimi i dokumenteve të mbledhura | 2025-2026 | 0 | 10,000 | 10,000 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Instituti për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë | Të dhenat e adminsitruar a | Ligji për Institutin për Dokumentimin e Krimeve të kryera gjatëLuftës në Kosovë | Materialet e mbledhura gjatë periudhës 2025 vijnë nga 13 shtete të ndryshme, përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Gjermaninë, Zvicrën, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-në, Kanadanë, Suedinë, Norvegjinë dhe |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Austrinë. IKKL ka pasuruar arkivin me materiale me vlerë të veçantë për dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.<br>Gjatë periudhës raportuese, janë nënshkruar mbi 582 procesverbale dorëzimi, që përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të transparencës dhe profesionalizimit të procedurave te mbledhjes se materialeve arkivore të Institutit. Fondi fizik i materialeve arkivore i IKKL-së arrijë në 400.25 metra linearë, krahasuar, ndërsa arkivi elektronik përmban gjithsej 21 TB të dhëna digjitale, përfshirë 245 kaseta VHS/mini-kaseta dhe 156 CD<br>Të gjitha |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | dokumentet e mbledhura, si në formë fizike ashtu edhe digjitale, janë klasifikuar dhe sistemuar në arkivin e IKKL-së. |
| **1.4** | **Objektivi specifik: Krijimi i Komisionit Presidencial** | | | | | | | | | |
| 1.4.1 | Grupi përgatitor për krijimin e Komisionit | T M3 2024 | 87,912 .00 | 0 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës/Kuve ndi i Kosovës | Grupi përgatitor funksional | N/A | Zyra e Presidentes ka themeluar një Grup Punues. Në ndërkohë ka organizuar tri takime me akter të shoqërisë civile, akter ndërkombëtar dhe përfaqësues të kategorive të viktimave. |
| 1.4.2 | Përgatitja për krijimin e Komisionit Presidencial | 20 24 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës/Kuve ndi | Akti i miratuar | N/A | Zyra e Presidentes është duke e përgatitur draftin e aktit normativ. |
| 1.4.3 | Funksionalizi mi i Komisionit Presidencial | 20 25 - 2026 | 0 | 1,202,6 25.6 5 | 1,202, 625.6 5 | Buxheti i Kosovës/D onator ët | Kryetari/Ku vendi | Funksioni mi i plotë i Komisionit | N/A | I pazbatuar, në pritje të planit. |
| **2.** | **Objektivi strategjik: Qasja në drejtësi dhe luftimi i mosndëshkimit për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga shteti i Serbisë, si çështje e drejtësisë për viktimat** | | | | | | | | | |
| **2.1** | **Objektivi specifik: Forcimi i sistemit të drejtësisë dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë** | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 | Rekrutimi dhe rritja e numrit të prokurorëve që merren me hetimin e krimeve të kryera gjatë luftës | 2024 - 2025 | 40,920.00 | 61,380.00 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Këshilli Prokurorial i Kosovës/Ministria e Drejtësisë | 5 Prokurorët e rekrutuar | Strategjia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit | Pjesërisht e zbatuar |
| 2.1.2 | Rekrutimi i stafit mbështetës të Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës | 2024 - 2025 | 44,880.00 | 22,440.00 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | 6 Stafi i rekrutuar | Strategjia për krimet e luftës nga Këshilli i Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit | Nuk kemi pranuar të dhëna. |
| 2.1.3 | Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve për prokurorët dhe personelin mbështetës të punësuar dhe të rekrutuar | 2025 - 2026 | 0 | 15,000.00 | 15,000.00 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Zyra e Kryeprokurorit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës/Akademia e Drejtësisë | Prokurorët dhe stafi mbështetës të trajnuar | Strategjia për krimet e luftës nga Këshilli i Prokurorisë dhe Prokurori i Shtetit | Akademia e Drejtësisë është në proces të përfshirjes se programit të posaçëm në programet e trajnimit. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.4 | Rekrutimi i stafit të nevojshëm në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Luftës në Policinë e Kosovës | 2024 - 2025 | 46,200.00 | 46,200.00 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Policia e Kosovës | 10 Stafi i rekrutuar | Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë | Gjatë vitit 2024 janë rekrutuar 8 veta, (4 nga ta kane caktim te përkohshëm)<br><br>Është krijuar zyra e statistikave dhe Analizës ne kuadër te Drejtorisë se Hetimeve te Krimeve te Luftës |
| 2.1.5 | Identifikimi i nevojave për pajisjet e nevojshme për hetimin e krimeve të kryera gjatë luftës | 2024 – 2025 - 2026 | 15,000.00 | 20,000.00 | 20,000.00 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës | Pajisjet e marra | N/A | Është kërkese ne proces |
| 2.1.6 | Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve për policët e rekrutuar | 2025 - 2026 | 0 | 15,000.00 | 15,000.00 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Policia e Kosovës/Akademi për Siguri Publike | Policët e trajnuar | N/A | Për periudhën Janar-tetor 2024 zyrtarët në Drejtorinë për Hetimin e Krime të Luftës kane kryer 9 trajnime për ketë fushe , ku kane mare pjese 55 zyrtar. |
| 2.1.7 | Prioritizimi i rasteve dhe përzgjedhja e rasteve në bazë të kritereve të përcaktuara | 2024 – 2025 - 2026 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | Efikasiteti i zgjidhjes së çështjeve gjyqësore | Strategjia për krimet e luftës nga Këshilli | Nuk kemi pranuar të dhëna. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Prokurori al dhe Prokurori i Shtetit | |
| 2.1.8 | Zhvillimi i bazës së të dhënave për krimet e rënda sipas të drejtës ndërkombëtare në Kosovë në Zyrën e Prokurorit Special | 20 25 | 0 | 10,000. 00 | 0 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | Baza e të dhënave e krijuar | Strateg jia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurori al dhe Prokurori i Shtetit | Nuk kemi pranuar të dhëna. |
| 2.1.9 | Përditësimi i regjistrit elektronik të Zyrës së Prokurorit Special | 20 24 – 2025 - 2026 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | Regjistri elektronik i përditësuar | Strateg jia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurori al dhe Prokurori i Shtetit | Nuk kemi pranuar të dhëna. |
| 2.1.1 0 | Zhvillimi i programit për mbrojtjen e dëshmitarëve | 20 24 - 2025 - 2026 | 20,000 .00 | 20,000. 00 | 20,000 .00 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | Sistemi ose programi i zhvilluar | Strateg jia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurori al dhe Prokurori | Nuk kemi pranuar të dhëna. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | i Shtetit | |
| 2.1.1 1 | Zhvillimi i protokollit hetimor të krimeve të luftës | 20 24 - 2025 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës | Protokolli dhe Strategjia të zhvilluara | Strateg jia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurori al dhe Prokurori i Shtetit | Nuk kemi pranuar të dhëna. |
| 2.1.1 2 | Ndryshim plotësimi I Ligjit Nr.04/L-017 Për ndihmë juridike falas | 20 24 - 2025 - 2026 | 1,500. 00 | 0 | 0 | Buxheti i Kosoves/ Donatorët | Ministria e Drejtësisë/Av okati i Viktimave | Ligji i ndryshuar | | Është hartuar koncept dokumenti dhe është i themeluar Grupi Punues. Ku janë mbajtur tri takime. |
| 2.1.1 3 | Hartimi i udhëzuesit për informimin e viktimave të krimeve të luftës për kompensimin e dëmeve në procedurat penale | 20 24 | 0 | 0 | 0 | | Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës /Policia e Kosovës | Udhëzimi i hartuar | Strateg jia për krimet e luftës nga Këshilli Prokurori al dhe Prokurori i Shtetit | Nuk kemi pranuar të dhëna. |
| 2.1.1 4 | Krijimi Zyrës për Mbështetjen e Viktimave | 20 24 | 44,880 .00 | 44,880. 00 | 0 | Buxheti i Kosovës/ Donatorët | Zyra e Prokurorit Special të | Themelimi i zyres me 8 persona | | Nuk kemi pranuar të dhëna. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | -<br>2025 | | | | | Republikës së Kosovës | Mbështetja për viktimat që kalojnë nëpër procese gjyqësore e ofruar | | |
| **2.2** | **Objektivi specifik: Rishikimi i kornizës ligjore ekzistues në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe nevojat e identifikuara në nivel kombëtar** | | | | | | | | | |
